



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 dhe 17, pika o) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008 , Ligjit nr.04/L-071 për sistemin e adresave, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.29 e datës 27 dhjetor 2011, nenit 9 pika o) dhe nenit 20 par 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 28.07.2022, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR EMËRIMIN E RRUGËVE TË REJA , SHESHEVE DHE HAPËSIRAVE PUBLIKE DHE RISHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR RIEMËRIMIN E RRUGËVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT

I .Me këtë Vendim, formohet Komisioni për emërimin e rrugëve të reja , shesheve dhe hapësirave publike dhe rishqyrtimin e kërkesave për riemërimin e rrugëve në territorin e komunës së Lipjanit konform Vendimit të Kuvendit të Komunës për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Lipjanit, 15Nr-344 i datës 06.08.2013, në përbërje si vijon:

1. Imri Smetishti, Drejtorati për planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Kryesues
2. Anila Reqica-Llugiqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport anëtar
3. Nexhmedin Lekiqi, nga subjekti politik LDK, anëtar
4. Gazmend Qerkini, nga subjekti politik LDK, anëtar
5. Ardit Cani, nga subjekti politik PDK, anëtar
6. Fatmir Fetahu, nga subjekti politik LVV, anëtar
7. _____ Kryetarët e fshatit, lagjeve urbane përkatëse në të cilin emërtohen rrugët , anëtar

II. Detyrë e komisionit është që të bëj emërimin e rrugëve të reja , shesheve dhe hapësirave publike dhe rishqyrtimin e kërkesave për riemërimin e rrugëve në territorin e komunës së Lipjanit në përputhje me Ligjin nr.04/L-071 për sistemin e adresave si dhe konform Vendimit të Kuvendit të Komunës për emërtimin, riemërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Lipjanit, 15Nr-344 i datës 06.08.2013, në konsultim dhe pajtueshmëri me këshillat e fshatrave dhe lagjeve urbane përkatëse. Vetëm kërkesat e pranuar për rishqyrtimin e emërtimeve të pranuar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi do të trajtohen.

III.Komisioni pas përfundimit të punëve do të hartojë Propozim-Vendimin të ri për emërimin, riemërtimin e rrugëve , shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Lipjanit. Në rast se ndryshimet do të jenë të pakëta do të propozohet vetëm ndryshim-plotësim i vendimit në fuqi për emërtimin, riemërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Lipjanit, 15Nr-344 i datës 06.08.2013. Propozim Vendimi i hartuar nga Komisioni do të kalojë përmes Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe do të dërgohet për miratim në Kuvendin e Komunës.

IV. Punët administrativo teknike për Komisionin do ti kryej Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

VI.Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për takimet e mbajtura do të kompensohen në lartësinë e një kompenzimi, i cili u paguhet për pjesëmarrje në mbledhje anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa konform dispozitave të legjislacionit në fuqi.

VII. Afati kohor për përfundimin e punëve është më së largu deri në fund të vitit 2023

VIII.Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

IX. Vendimi u dërgohet kordinatorit dhe anëtarëve të komisionit.

Nr. 15-020/04-40406

Lipjan, më 28.07.2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

**Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi**

